



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI  
KOMISIONERI**

Nr.1424/1 Prot.

Tiranë, më 04.08. 2026

**V E N D I M**

**Nr. 211, Datë 04.08. 2026**

Bazuar në nenet 32 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar<sup>1</sup>, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është regjistruar ankesa nr. 179 Regj., datë 22.07.2026, e paraqitur nga znj. D.P kundër z.B.G , Ministër i Turizmit, Kulturës dhe Sportit, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “gjendjes shëndetësore” dhe “përkatësisë në një grup të veçantë”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues**

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit ankuesja znj.D.P , parashtron se, z. B.G , Ministër i Turizmit, Kulturës dhe Sportit, në një dalje publike i është drejtuar protestuesve, si një tufë budallenjsh, duke prezumuar paaftësi intelektuale dhe mendore nga ana e tyre. Sipas ankuses, kjo deklaratë prek drejtpërdrejtë parashikimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konkretisht diskriminimin për shkak të gjendjes shëndetësore. Sipas ankuses, duke përdorur këtë term dhe konotacion, z.G. ka diskriminuar në të vërtetë personat që kanë faktikisht probleme të shëndetit mendor, duke prezumuar që ata nuk kanë të drejta si gjithë të tjerët.

Përfundimisht, pala ankuese kërkon nga Komisioneri marrjen e masave të mëposhtme:

- Të ndalohet gjuha e urrejtjes nga ana e funksionarëve publikë;
- Të kërkohej ndjesë publike nga ana e tij;
- Të gjobitet subjekti që ka shkelur ligjin sipas parashikimeve;

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

<sup>2</sup>Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

## II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1, të Ligjit Nr.10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar përcaktohet se: **“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, **gjendjen shëndetësore**, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, **përkatësinë në një grup të veçantë**, ose me çdo shkak tjetër.”**

Bazuar në nenin 3, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar diskriminimi përcaktohet si : “çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”

Bazuar në nenin 4, germa “a”, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “1. Ky ligj zbatohet për sektorin publik dhe privat duke përfshirë edhe institucionet publike, si dhe të gjithë personat, përfshirë, por pa u kushtëzuar në: a) të gjithë shtetasit shqiptarë, të huaj apo personat pa shtetësi, si dhe personat fizikë e juridikë vendas dhe të huaj që kanë vendbanim, vendqëndrim apo seli në territorin e Republikës së Shqipërisë.”

Bazuar në nenin 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, përcaktohet se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim.”

Bazuar në nenin 32, pika 1, shkronjat “a”, “b” dhe “c” të Ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar përcaktohet se: “1. Komisioneri ka kompetencë: a) të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj dhe në ligjin “Për barazinë gjinore në shoqëri”; b) të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive; c) të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji”

Bazuar në nenin 33, pikat 1 dhe 2, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar përcaktohet se: “1. Një person ose grup personash që pretendojnë se janë diskriminuar, ose një organizatë me interesa legjitime që pretendon diskriminim në emër të një personi apo grupi personash, mund të paraqesë ankesë së bashku me provat e disponueshme para komisionerit, me shkrim ose, në raste përjashtimore, gojarisht, në mënyrë që të mund të mbahet procesverbal. 2. Organizata me interesa legjitime mund të kërkojnë kryerjen e hetimeve administrative nëpërmjet disponimit të informacionit të besueshëm, si dhe të përfaqësojnë një person ose grup personash, pasi të jetë marrë pëlqimi me shkrim ose të mbahet procesverbal në prani të një punonjësi të institucionit, për të përfaqësuar personin ose grupin e personave.”

Bazuar në nenin 32, pika 3, të Ligjit nr.10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar përcaktohet se: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.”

Bazuar në nenin 3, pika 7, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: “7. “Palë” është: a) çdo person fizik ose juridik, i cili ka të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pika 1, të këtij Kodi;”

Bazuar në nenin 33, pika 1 dhe 2, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: përcaktohet se: “1. Palë në procedurën administrative, përveç sa parashikohet në nenin 3, të këtij Kodi, është çdo person: a) me kërkesë të të cilit ka filluar procedura administrative; b) ndaj të cilit ka filluar procedura admini-strative, ose të cilit i drejtohet apo synohet t’i drejtohet vendimi i procedurës administrative; ose c) me të cilin organi publik synon të lidhë apo ka lidhur një kontratë administrative. 2. Në procedurën administrative janë gjithashtu palë edhe mbajtësit e interesave publikë të autorizuar me ligj, si dhe mbajtësit e interesave kolektive apo interesave të gjerë të publikut, nëse këta interesa mund të cenohen nga rezultati i procedurës administrative.”

#### - Vlerësimi i Komisionerit

Ligji nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, bën dallim të qartë ndërmjet personit ose grupit të personave që pretendojnë se janë diskriminuar; organizatës me interesa legjitime që vepron në emër të viktimave ose për interesa kolektive dhe kompetencës së Komisionerit për të filluar hetim administrativ pas marrjes së informacionit të besueshëm.

Neni 32, pika 1, pika “a”, i ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikon se Komisioneri ka kompetencë të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar. Pika “b”, e po këtij neni, parashikon shqyrtimin e ankesave nga organizatat që kanë interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve që pretendojnë diskriminim, ose në emër të tyre për çështje që lidhen me

interesa kolektive, ndërsa pika “c” i njeh Komisionerit kompetencën të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të ligjit.

Sipas nenit 3, pika 11, të ligjit, “*Organizatat me interesa legjitime*” janë organizatat e regjistruara në Republikën e Shqipërisë që kanë si objekt të deklaruar të veprimtarisë mbrojtjen e të drejtave të njeriut ose u ofrojnë ndihmë viktimave të diskriminimit. Neni 3, pika 18, përcakton se “*Viktimë*” është çdo person ose grup personash që pretendojnë se janë diskriminuar sipas ligjit, bazuar në një shkak të mbrojtur.

Neni 32, pika 1, shkronjat “a” dhe “b” dhe neni 33, pikat 1 dhe 2, të LMD-së i njohin të drejtën çdo personi ose grupi personash që pretendojnë se janë diskriminuar, çdo organizate me interesa legjitime që pretendon diskriminim në emër të një personi apo grupi personash, ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive, për të paraqitur ankesë para Komisionerit. Këto dispozita të marra së bashku me nenin 3, pika 7, të Kodit të Procedurave Administrative, kërkojnë që pala që paraqet ankesën për diskriminim pranë Komisionerit të ketë një interes legjitim të drejtpërdrejtë në procedurën administrative që kërkon të iniciojë nëpërmjet paraqitjes së ankesës.

Ankuesja znj.D.P , ka paraqitur një ankesë individuale si person. Pra, në rastin konkret, që ankuesja të legjitimohet si palë në procedurën administrative para Komisionerit duhet që të ketë një interes legjitim personal të drejtpërdrejtë.

Në ankesën objekt shqyrtimi, ankuesja, znj. D.P , ka denoncuar faktin se z. B.G , Ministër i Turizmit, Kulturës dhe Sportit, në një dalje publike, iu është drejtuar protestuesve duke i cilësuar si “*një tufë budallenjsh*”, duke prezumuar në këtë mënyrë paaftësi intelektuale dhe mendore nga ana e tyre. Sipas ankueses, kjo shprehje përbën diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore, pasi nënkupton që personat me probleme të shëndetit mendor nuk gëzojnë të drejta si gjithë të tjerët, si dhe diskriminim për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë.

Komisioneri vëren se, ankuesja nuk është synuar personalisht nga deklarata e z. B.G dhe se, nuk pretendohet nga ana e saj se ajo mbart shkaqet e mbrojtura të diskriminimit. Komisioneri vlerëson në këto kushte se, ankuesja nuk provon se ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe personal për paraqitjen e ankesës objekt shqyrtimi.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, ankuesja, duke mos patur një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe personal, nuk ka legjitimitet aktiv për të paraqitur këtë ankesë<sup>3</sup>.

Ankuesja nuk mund t’i drejtohet Komisionerit për mbrojtjen e të drejtave apo interesave publike që i drejtohen një komuniteti në tërësi apo një grupi shoqëror. Pretendimi se një praktikë/deklaratë mund të prekë potencialisht kategori të gjera të shoqërisë nuk i jep automatikisht çdo personi

---

<sup>3</sup> Për referencë shih vendimet nr.70, datë 13.07.2020 dhe nr.136, datë 02.06.2025, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

cilësinë e përfaqësuesit të atyre kategorive. Interesi publik nuk është i njëjtë me legjitimimin procedural individual. Mbajtësit e interesave publikë ose kolektivë marrin cilësinë e palës vetëm kur autorizohen nga ligji, ndërsa Ligji nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar ia njeh në mënyrë të posaçme veprimin për interesa kolektive organizatave me interesa legjitime dhe vetë Komisionerit, në kuadër të kompetencës së tij për hetim kryesisht.

Në këtë kuptim, për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave apo interesave publike në fushën e të drejtave të njeriut, barazisë dhe mosdiskriminimit, legjislacioni në fuqi ka legjitimuar për të qenë palë në një procedurë administrative, mbajtësit e interesave publike/kolektivë, që mund të jenë organizata të ndryshme të njohura me ligj dhe që kanë si qëllim mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Në këtë kontekst, është praktikë e institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi që kur diskriminimi i pretenduar nuk i adresohet personalisht një personi, por prek një komunitet në tërësi, pra cenon interesa kolektivë apo publikë, ankesa të formësohet nga një organizatë me interes të ligjshëm dhe jo nga çdo individ.<sup>4</sup>

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, çështja në fjalë është një çështje që i përket interesit publik/kolektiv dhe nuk ka të bëjë me interesin e drejtëpërdrejtë dhe personal të ankueses. Në këto kushte për të bërë një ankesë para Komisionerit do të legjitimoheshin subjektet që janë mbajtës të interesave kolektive apo interesave të gjerë të publikut në fushën e të drejtave të njeriut, barazisë dhe mosdiskriminimit.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, pasi pala ankuese nuk legjitimohet për paraqitjen e ankesës, dhe në këto kushte, bazuar në nenin 33, pika 4, germa “b”, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: b) ..... është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji.....”, ankesa objekt shqyrtimi nr. 179, datë 22.07.2026, e paraqitur nga ankuesja D.P , nuk duhet të pranohet si e papajtueshme me dispozitat e ligjit.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenet 32 dhe 33, pika 4, germa “b”, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

---

<sup>4</sup> Për referencë shih vendimet: Nr.62, datë 17/06/2020, Nr.63, datë 17/06/2020, Nr. 64, datë 17/06/2020, Nr.15, datë 30/01/2019, Nr.36, datë 05/03/2019, Nr.120, datë 09/09/2019, Nr.125, datë 01/08/2014, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

## **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës me Nr.179 Regjistri, datë 22.07.2026, të paraqitur nga znj.D.P , pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në gjykatë, brenda afatit 45 ditor nga marrja dijeni, sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurës Administrative.

**KOMISIONER**

**Genta TAFA (BUNGO)**

Shkaku: Gjendje shëndetësore, përkatësia në një grup të veçantë  
Fusha: Gjuhë urrejtje  
Lloji i vendimit: Mospranim